



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL  
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 02.02.2024

## NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, me Urdhër të Kryeministrit nr.81, datë 10.05.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, shpall pozicionin si më poshtë:

- **PUNONJËS MIRËMBAJTJE** (me kontratë pune të përkohshme 8h/ditë)
- **Detyrat kryesore të Punonjësit të Mirëmbajtjes**
  - Riparon dhe mirëmban dhe instalon elemente të sistemit elektrik, hidro-sistemit, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
  - Kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirë së jashtme dhe të brendshme;
  - Mban evidencë rreth servisit të pajisjeve (kondicioner, pajisje hidrosanitare etj);
  - Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të institucionit;
  - I përgjigjet të gjitha kërkesave të institucionit.
- **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**
  1. Të kenë mbaruar arsim profesional/ arsim i mesëm.
  2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
  3. Të kenë përvojë pune të mëparshme si mirëmbajtës.
- **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**
  - Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
  - Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
  - VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 08.02.2024, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

---

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**